



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/21

Datë: 07.08.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24A, Paragrafi 1, i Ligji Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 gusht 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej dyzetekatër milion e shtatëqind mijë e një qind e pesëdhjetë e dy euro (44,700,152.00 €) me qëllim të rimbursimit të shpenzimeve nga ekzekutimi i masave: Nr. 1.1, Nr. 1.2, Nr. 1.3, Nr. 1.4, Nr. 1.7, Nr. 1.8, Nr. 1.14 dhe Nr. 1.15, sipas Vendimit Nr. 01/19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 30.03.2020, i plotësuar dhe ndryshuar.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga nën programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike", me numër të kodit 29300, kategoria subvencione dhe transfere, në kuadër të organizatës buxhetore Ministria e Financave, dhe ndahen për organizatat buxhetore me shuma si në vijim:
 - 2.1. Shuma prej dhjetë milion euro (10,000,000.00 €) ndahet për organizatën buxhetore Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, me kod 213, në programin "Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike" me kod 23300, kategoria subvencione dhe transfere;
 - 2.2. Shuma prej tetë milion e dyqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë euro (8,212,816.00 €) ndahet për organizatat buxhetore, në nën programet dhe kategoritë e shpenzimeve, si në vijim:
 - 2.2.1. Shuma prej pesë milionë e katërqind e tridhjetë mijë e pesëqind e katër dhjetë e tetë euro (5,430,548.00 €), ndahet për Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, sipas detajeve të paraqitura në Shtojcën bashkëngjitur këtij vendimi;
 - 2.2.2. Shuma prej dy milion e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzetë e pesë euro (2,386,645.00 €) ndahet për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, sipas detajeve të paraqitura në Shtojcën bashkëngjitur këtij vendimi; dhe
 - 2.2.3. Shuma prej treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzetë e tre euro (395,623.00 €) ndahen për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, sipas detajeve të paraqitura në shtojcën bashkëngjitur këtij vendimi.

2.3. Shuma prej njëzetë e gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë euro (26,487,336.00 €) ndahet për organizatën buxhetore Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me kod 209, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfereve, për nën programet si në vijim:

2.3.1 Në nën programin "Kompensimi për të Verbrit" me kod 02700, në shumë prej tridhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë euro (35,250.00 €);

2.3.2 Në nën programin "Ndihamat Sociale" me kod 00500, në shumë prej dhjetë milion e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë euro (10,615,570.00 €);

2.3.3 Në nën programin "Pensionet Bazike - Sociale" me kod 00100, në shumë prej dymbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e tetëmijë mijë e gjashtëqind e tridhjetë euro (12,738,630.00);

2.3.4. Në nën programin "Pensionet e Aftësisë së Kufizuar" me kod 00200, në shumë prej dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzetë euro (2,498,220.00);

2.3.5 Në nën programin "Pensionet e Kontribut-dhënëse" me kod 01200, në shumë pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtë euro (51,506.00 €);


2.3.6 Në nën programin "Pensioni Familjar" me kod 02900, në shumë dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e pesëqind e gjashtë dhjetë euro (286,560.00 €);

2.3.7. Në nën programin "Pensioni Invalidor i Punës" me kod 03000, në shumë prej tetëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë euro (8,460.00 €); dhe

2.3.8. Në nën programin "Shërbimet Sociale" me kod 00600, në shumë prej dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e dyzetë euro (253,140.00€);

3. Në rast se ndarja e mjeteve për rimbursim të shpenzimeve sipas pikës 1. të këtij vendimi rezulton në tepricë në cilëndo nga nën-programet buxhetore pas realizimit të bartjes së shpenzimit në pajtim me Neni 18 të ligjit Ligji Nr. 07/L-014, paragrafi 1, mjetet e ndara sipas këtij vendimi nga organizatat buxhetore kthehen në nën programin "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" në Ministrinë e Financave dhe, sipas nevojës, ri destinohen për rimbursimin e masave të rimëkëmbjes ekonomike.
4. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Shtojcë

| Unja buxhetore prej ku janë marrë mjetet | Përshkrimi i Programit / Projektit | Shuma e mjeteve të marra | OB | Kodi | Blloku i ri kodues ku transferohen mjetet |
|--|--|--------------------------|------|------|---|
| 10/204/24000/130/00000/1090 | Departamenti i Rezervave | 118,936.00 | MTI | 204 | 10/204/24000/130/00000/1090 |
| 10/204/26900/130/00000/0411 | Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit | 6,070.00 | MTI | 204 | 10/204/26900/130/00000/0411 |
| 10/204/41000/130/00000/0411 | Departamenti i Industrisë | 11,225.00 | MTI | 204 | 10/204/41000/130/00000/0411 |
| 10/204/41100/130/00000/0411 | Departamenti i Tregtisë | 22,839.00 | MTI | 204 | 10/204/41100/130/00000/0411 |
| 10/204/41200/130/00000/0411 | Agjenda Kosovare për Standartizim | 6,584.00 | MTI | 204 | 10/204/41200/130/00000/0411 |
| 10/204/42900/130/00000/0411 | Agjencia për Pronësi Industriale | 10,876.00 | MTI | 204 | 10/204/42900/130/00000/0411 |
| 10/204/45600/130/00000/0411 | Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Ko | 9,399.00 | MTI | 204 | 10/204/45600/130/00000/0411 |
| 10/204/46500/130/00000/0411 | Agjencia e Metrologjisë së Kosovës | 14,395.00 | MTI | 204 | 10/204/46500/130/00000/0411 |
| 10/204/46500/300/13449/0411 | Renovimi i Objektivit të MTI-se | 69,972.00 | MTI | 204 | 10/204/46500/300/13449/0411 |
| 10/204/46600/130/00000/0411 | Inspektoriat i Tregut | 24,242.00 | MTI | 204 | 10/204/46600/130/00000/0411 |
| 10/204/46800/130/00000/0473 | Departamenti i Turizmit | 3,324.00 | MTI | 204 | 10/204/46800/130/00000/0473 |
| 10/204/49100/130/00000/0432 | Departamenti për Rreg.Tregut të naftës | 2,834.00 | MTI | 204 | 10/204/49100/130/00000/0432 |
| 10/204/49200/130/00000/0411 | Departamenti për Kontrollin e Tregut Malira | 2,328.00 | MTI | 204 | 10/204/49200/130/00000/0411 |
| 10/204/49300/130/00000/0411 | Divizioni për Investime Strategjike | 31,809.00 | MTI | 204 | 10/204/49300/130/00000/0411 |
| 10/204/41400/130/00000/0411 | Regjistri Kosovar i Bizneseve | 13,771.00 | MTI | 204 | 10/204/41400/130/00000/0411 |
| 10/204/41400/300/13351/0411 | Softverit i Programit të ARBK-se | 12,495.00 | MTI | 204 | 10/204/41400/300/13351/0411 |
| 10/204/26800/130/00000/0411 | Departamenti për Integrim | 3,811.00 | MTI | 204 | 10/204/26800/130/00000/0411 |
| 10/204/11304/300/13349/0411 | Renovimi i Objektivit të MTI-se | 4,998.00 | MTI | 204 | 10/204/11304/300/13349/0411 |
| 10/204/11404/130/00000/0411 | Zyra e Ministrit | 25,715.00 | MTI | 204 | 10/204/11404/130/00000/0411 |
| 10/204/43800/130/00000/0435 | Departamenti i Energjisë | 14,862.00 | MEA | 213 | 10/213/43800/130/00000/0435 |
| 10/204/43800/300/12722/0435 | Auditimi energjetik i ndërtesave publike... | 634,746.00 | MEA | 213 | 10/213/43800/300/12722/0435 |
| 10/204/43900/200/00000/0441 | Minierat | 1,249.00 | MEA | 213 | 10/213/43900/200/00000/0441 |
| 10/204/44100/130/00000/0441 | Inspektoriat | 1,438.00 | MEA | 213 | 10/213/44100/130/00000/0441 |
| 10/204/22400/200/00000/0436 | Ngrohja Qendrore | 99,960.00 | MEA | 213 | 10/213/22400/200/00000/0436 |
| 10/204/22500/200/00000/0474 | Uji dhe Hedhurinat | 249,900.00 | MEA | 213 | 10/213/22500/200/00000/0474 |
| 10/204/22500/300/18055/0520 | Projekti për uje dhe kanalizim për zonat ... | 749,700.00 | MEA | 213 | 10/213/22500/300/18055/0520 |
| 10/204/23300/130/00000/0133 | Njësia për Politikat dhe Monitorimin e NP. | 59,945.00 | MEA | 213 | 10/213/23300/130/00000/0133 |
| 10/204/23300/200/00000/0133 | Njësia për Politikat dhe Monitorimin e NP. | 174,930.00 | MEA | 213 | 10/213/23300/200/00000/0133 |
| 10/204/27600/200/00000/0453 | Trankos | 349,860.00 | MEA | 213 | 10/213/27600/200/00000/0453 |
| 10/204/27700/200/00000/0453 | Infrakos | 424,830.00 | MEA | 213 | 10/213/27700/200/00000/0453 |
| 10/204/42300/130/00000/0460 | Departamenti i Post-Telekomunikacionit dh | 38,744.00 | MEA | 213 | 10/213/42300/130/00000/0460 |
| 10/204/42300/300/15373/0412 | Programi i zbatimit të ekonomisë digjitale | 159,936.00 | MEA | 213 | 10/213/42300/300/15373/0412 |
| 10/204/42300/300/18063/0460 | Ekonomia Dixhitale në Kosovë | 887,145.00 | MEA | 213 | 10/213/42300/300/18063/0460 |
| 10/204/22800/200/00000/0441 | Minierat e Trepçës | 880,365.00 | MEA | 213 | 10/213/22800/200/00000/0441 |
| 10/204/27100/130/00000/0490 | Departamenti i Politikave të Zhvillimit Ekon | 2,255.00 | MEA | 213 | 10/213/27100/130/00000/0490 |
| 10/204/27100/200/00000/0490 | Departamenti i Politikave të Zhvillimit Ekon | 1,499.00 | MEA | 213 | 10/213/27100/200/00000/0490 |
| 10/204/27300/130/00000/0484 | Shërbimi Gjeologjik i Kosovës | 17,207.00 | MEA | 213 | 10/213/27300/130/00000/0484 |
| 10/204/27300/300/13609/0484 | Laboratori i IGJK-se | 87,465.00 | MEA | 213 | 10/213/27300/300/13609/0484 |
| 10/204/27400/130/00000/0260 | Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energji | 4,748.00 | MEA | 213 | 10/213/27400/130/00000/0260 |
| 10/204/27400/200/00000/0260 | Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energji | 249,900.00 | MEA | 213 | 10/213/27400/200/00000/0260 |
| 10/204/27400/300/15372/0435 | 2 Programi i zbatimit të masave të EE | 264,894.00 | MEA | 213 | 10/213/27400/300/15372/0435 |
| 10/204/27400/300/18364/0435 | Zbatimi i masave të EE dhe BRE në Qendren... | 74,970.00 | MEA | 213 | 10/213/27400/300/18364/0435 |
| 10/204/43100/130/00000/0412 | Shërbimet e Punësimit | 80,613.00 | MPMS | 209 | 10/209/43100/130/00000/0412 |
| 10/204/43100/132/00000/0412 | Shërbimet e Punësimit | 23,666.00 | MPMS | 209 | 10/209/43100/132/00000/0412 |
| 10/204/43100/200/00000/0412 | Shërbimet e Punësimit | 1,949,220.00 | MPMS | 209 | 10/209/43100/200/00000/0412 |
| 10/204/91200/130/00000/0950 | Shërbimet e Aftësisimit Profesional | 51,956.00 | MPMS | 209 | 10/209/91200/130/00000/0950 |
| 10/204/91200/132/00000/0950 | Shërbimet e Aftësisimit Profesional | 17,164.00 | MPMS | 209 | 10/209/91200/132/00000/0950 |
| 10/204/91200/200/00000/0950 | Shërbimet e Aftësisimit Profesional | 49,980.00 | MPMS | 209 | 10/209/91200/200/00000/0950 |
| 10/204/43200/130/00000/0412 | Inspektoriat i Punës | 25,046.00 | MPMS | 209 | 10/209/43200/130/00000/0412 |
| 10/204/43200/132/00000/0412 | Inspektoriat i Punës | 5,323.00 | MPMS | 209 | 10/209/43200/132/00000/0412 |
| 10/204/43200/300/12178/1050 | Renovimi i objektivit egzistues dhe ne Komuna... | 2,499.00 | MPMS | 209 | 10/209/43200/300/12178/1050 |
| 10/204/43200/300/13889/1050 | Blerja e veturave | 21,242.00 | MPMS | 209 | 10/209/43200/300/13889/1050 |
| 10/204/43100/300/14308/1050 | Ndërtimi i Agjencionit të Punësimit | 84,966.00 | MPMS | 209 | 10/209/43100/300/14308/1050 |
| 10/204/43100/300/18165/1050 | Ndërtimi i Zyres së Punësimit në Gjakovë | 74,970.00 | MPMS | 209 | 10/209/43100/300/18165/1050 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/21

Datë: 07.08.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24A, Paragrafi 1, i Ligji Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 gusht 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej pesëdhjetë milionë e pesëqind mijë euro (50,500,000.00 €) me qëllim të vazhimit të ekzekutimit të masave: Nr. 1.3, Nr. 1.7, Nr. 1.8, Nr. 1.14 dhe Nr. 1.15, sipas Vendimi Nr. 01/19 të datës 30.03.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar.
2. Mjetet nga pika 1 e këtij Vendimi merren nga nën programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike", me numër të kodit 29300, kategoria subvencione dhe transfere, në kuadër të organizatës buxhetore Ministria e Financave, dhe ndahen për organizatat buxhetore me shuma si në vijim:
 - 2.1. Shuma prej dyzet milion euro (40,000,000.00 €) ndahet në organizatën buxhetore Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, me kod 213, në programin "Ndërmarrësia" me kod 49400, kategoria subvencione dhe transfere, për mbulimin e masave Nr. 3 (a, b), Nr. 7, Nr. 8 dhe Nr. 14; dhe
 - 2.2. Shuma prej dhjetë milionë e pesëqind mijë euro (10,500,000.00 €) ndahen për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me kod 209, në nën programin "Ndihmat Sociale" me kod 00500, kategoria subvencione dhe transfere, për mbulimin e masës Nr. 1.15;
3. Mjetet për ekzekutimin e masave sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi alokohen nga Thesari i Kosovës (MF) vetëm për qëllimin e përcaktuar në këtë vendim, në bazë të kërkesës së organizatave buxhetore zbatuese të përcaktuara në pikën 2.1. dhe 2.2. të këtij vendimi, pas konfirmimit të listave për ekzekutim.
4. Në rast se ndarja e mjeteve për mbulimin e masave sipas pikës 2 dhe 3 të këtij vendimi rezulton në tepricë të mjeteve në cilëndo nga nën-programet buxhetore, mjetet e ndara sipas këtij vendimi nga organizatat buxhetore kthehen në nën programin "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" në Ministrinë e Financave dhe, sipas nevojës, ri destinohen me vendim të Qeverisë për financimin e masave të rimëkëmbjes ekonomike, në pajtim me nenin 24A të Ligjit Nr. 07/L-014.

5. Obligohet Ministria e Financave që mungesën eventuale të mjeteve për zbatimin e ndonjëres nga masat sipas pikës 1 të këtij vendimi ta plotësojë me vendim të veçante të Qeverisë së Republikës së Kosovës nga nën programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike", në baze të dinamikës së ekzekutimit të tyre.
6. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë